



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNËS - SHITIME
Komiteti për Politikë dhe Financa
Nr.01-060/01-10589/20 datë: 26.06.2020



Npi – 01/133 datë: 29.06.2020

Duke u bazuar në nenin 49 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, si dhe në bazë të nenit 3.11 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/149 datë: 31.05.2019, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur më: 29.06.2020 nxjerr këtë:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË JASHTËZAKONSHME TË KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA
E mbajtur më datën: 29.06.2020 (e hënë) në ora 11.00 h. në sallën e Kuvendit Nr.1

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesja znj.Medina Brahaj, pastaj anëtarët e Komitetit z.Perparim Ramusa, znj.Arbesha Sylja, z.Naim Zejna, znj.Zarife Rexhaj, z.Ruzhdi Jashari, dhe znj.Adelina Beqaj. Përveç anëtarëve të KPF-së në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: Zyrtarja Kryesore Financiare, znj.Kimete Ukaj; Zyrtari i IT-së z.Gazmend Ademaj. Mbledhjen e hapi, Kryesuesja e KPF-së znj.Medina Brahaj, e cila pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes. Për këtë mbledhje të Jashtëzakonshme kemi propozuar këtë:

REND DITE

1. Draft - Korniza Afatmesme Buxhetore 2021-2023. (pas diskutimit publik)

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Para se të hapë diskutimin për rendin e ditës, sqaroi për arsyen e ngutshme të mbajtjes së kësaj mbledhje, meqenëse Korniza Afatmesme Buxhetore 2021-2023, duhet të dorëzohet deri më 30 Qershor 2020. Në vazhdim hapi diskutimin për rendin e ditës. Meqenëse diskutime nuk kishte për rendin e ditës Kryesuesja Konstatoi kuorumin prej 6 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, me 5 vota “Për” me 0 vota “Kundër” dhe me 1 votë “Abstenim” aprovoi rendin e ditës.**

Pika 1

Draft - Korniza Afatmesme Buxhetore 2021-2023. (pas diskutimit publik)

Kryesuesja, znj.Medina Brahaj; Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Kimete Ukaj.
znj.Kimete Ukaj, Zyrtare Kryesore Financiare; Përshëndetje, KAB-in që ne sot po e prezantojmë para jush është pra dokumenti bazë për aprovimin e Buxhetit të Komunës. Baza ligjore është konsultuar dhe është përmbledhur në dokument. KAB-i miratohet për çdo vit, mbi bazën e dokumentit të KAB-it i cili vjen nga Ministria e Financave vendosen tavanet e shpenzimeve buxhetore mbi të cilat nuk mund të kalojmë. Ne e kemi hartuar Draft-dokumentin, duke marrë parasysh edhe diskutimet publike që i kemi organizuar sipas Vendimit të Kuvendit. Në vazhdim

Zyrtarja lexoi dokumentin me shifra konkrete sipas tabelave. (shih dokumentin). Nëse ka ndonjë pyetje unë jam këtu për tu përgjigjur.

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Konstatoi kuorumin prej 6 anëtarëve prezent në mbledhje.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, me 5 vota “Për” dhe me 1 votë “Kundër” vendosi që ti rekomandoj Kuvendit aprovimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore për periudhën 2021-2023.**

Kryesuesja, znj. Medina Brahaj; Pasi që diskutime tjera nuk kishte, Kryesuesja, mbledhjen e përfundoi në ora 11.15h.

Procesmbajtësi:
Idajet Rexhepi



Kryesuesja e KPF
Medina Brahaj

